Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/1066

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, Isa Hasani - Anëtar dhe Vjosa Gradinaj Mexhuani - Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) "ARMENDI BAU" SH.P.K., kundër Vendimit për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të "Komuna e Istogut" në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit "Riparimi i rrugëve lokale te rendit IV dhe sanimi i gjendjes nga vershimet.633-023-012-111". me numër të prokurimit 633-23-2733-1-1-1, me 20/02/2024, mori:

Vendim

1. Ankesa e "Armendi Bau" SH. P.K.- Istog. me nr. 2023/0649, e datës 04/09/2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Riparimi i rrugëve lokale të rendit IV dhe sanimi i gjendjes nga vërshimet" me numër të prokurimit 633-232733-1-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) - "Komuna e Istogut'', nga ana e këtij Paneli konsiderohet si çështje e gjykuar (**Res Judicata**) pasi që pretendimet ankimore janë trajtuar në Vendimin PSh. nr.2023/0649 i datës 20.11.2023, ku objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, andaj ky rast konsiderohet si çështje e gjykuar "**Res Judicata**".

2. Anulohet njoftimi për dhënie i shpallur nga AK, ndërsa aktiviteti i prokurimit kthehet në ri-vlerësim.

3. URDHËROHET Autoriteti Kontraktues- Komuna Istog që në afat prej 5 (pesë) ditësh të zbatojë vendimin e OSHP-së me numër: PSh. nr.2023/0649 i datës 10.11.2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Riparimi i rrugëve lokale të rendit IV dhe sanimi i gjendjes nga vërshimet" me numër të prokurimit 633-232733-1-1-1, dhe ta njoftoj OSHP

4.Mos respektimi i kësaj urdhërese në afat prej pesë ditësh do ta detyrojë Panelin Shqyrtues që të veproj konform nenit 131 të LPP-së dhe në të njëjtën kohë të kërkojë nga KRPP-ja, anulimin e licencës për menaxherin e prokurimit të AK-së /Komuna e Istogut, konform nenit 25 paragrafi 8 dhe 9 të LPP-së.

5.Lejohet kthimi i tarifës së paguar me parashtrimin e ankesës. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 27.03.2023, "Komuna e Istogut" në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar njoftimin për kontratë për aktivitetin e prokurimit me titull: "Riparimi i rrugëve lokale te rendit IV dhe sanimi i gjendjes nga vershimet.633-023-012-111" me nr. të prokurimit:633-23-2733-1-1-1. Ndërkaq me datën18.12.2023 është publikuar njoftimi mbi vendimin e AK me te cilin ka ka shpërblyer me kontratë OE "Shkëmbi SHPK".

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës për punë dhe me vlerë të parashikuar të kontratës **350,000.00 €**

Me 22.12.2023, OE "Armendi Bau" SH.P.K.- Istog, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 27.12.2023, Autoriteti Kontraktues ka hedhur poshtë si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 29.12.2023, OSHP ka pranuar ankesën nga OE "Armendi Bau" SH.P.K.- Istog me nr. 1066/23 lidhur me aktivitetin "Riparimi i rrugëve lokale të rendit IV dhe sanimi i gjendjes nga vërshimet " me numër të prokurimit 633-23-2733-1-1-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues"ARMENDI BAU" SH.P.K., *janë parashtruar si në vijim:*

Me datë 27.12.2023, kemi pranuar Letër standarde për [tenderuesin] [kandidatin] e eliminuar, ku na janë cekur disa arsye te pa pranueshme për eliminim. Duke ju referuar dosjes se tenderit dhe njoftimit për kontrate këto arsye nuk qëndrojnë sepse ne kemi plotësuar ne tërësi kushtet dhe kriteret e kërkuara,

po ashtu O.E i shpallur fitues nuk i plotëson kushtet e kërkuara dhe është i papërgjegjshëm me ç'rast AK Komuna e Istogut ka shkelur ne tërësi Ligjin e prokurimit Publik kur ka shpallur fitues një O.E të papërgjegjshëm.

Arsyet e eliminimit tonë sipas AK komuna e Istogut janë që: Grup i Operatorëve Ekonomik ARMENDI BAU SH.P.K.; Company Zuka Commerce Sh.p.k., Rr.Shpend Kukiqi nr.50, 31000, Suhogërllë Istog Sipas vendimit të AK njësisë së prokurimit komuna Istog të datës 17.07.2023 , Në marrëveshjen e Konzerciumit nuk është paraqitur deklarata e pjesëmarrësve ne konsersioum e nënshkruar dhe e vulosur nga të gjitha pjesëmarrësit e grupit, pasi qe ka konkurruar si grup i operatoreve të cilët kanë marre pjese dhe nuk e kane respektuar nenin 71 të LPP piken b te nenit 26 të Rregullores së Prokurimit Publik nr.001/2022 e cila Citojmë: Nëse një tender dorëzohet nga një grup i tillë, grupi duhet që së bashku me tenderin e tij të dorëzojë një deklarate të nënshkruar nga secili prej anëtarëve, që konfirmojnë pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk marrin pjesë në ndonjë grup tjetër që merr pjesë në të njëjtat procedura të prokurimit pran të njëjtit Autoritet Kontraktues për të njëjtin Aktivitet. Të gjitha Autoritetet Kontraktuese duhet që ta parashtrojë këtë kusht në dosjet e tyre të tenderit. Në rast së një anëtar merr pjesë në disa grupe, secili nga grupet përkatëse do të konsiderohen të papërshtatshëm-të pa përgjegjshëm rregulloren numër 001/2022 të datës 20.10.2022, Neni 26.1.pika b. *Dorëzon një deklaratë të nënshkruar nga secili nga anëtarët, që konfirmon pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se nuk janë duke marrë pjesë individualisht dhe/ose në grupe tjera në procedurën e njëjtë të prokurimit (deklarata elektronike mund të nënshkruhet duke përdorur nënshkrimin elektronik të avancuar nëse është i aplikueshëm.*

Këto pretendime nuk qëndrojnë sepse ne si konzorcium ne ofertën tone kemi dorëzuar marrëveshjen e konzorciumit (tek oferta jonë referoju File me emërtimin 1. Marrëveshja e konzoriumit), ku kemi bere deklaratë me shkrim qe jemi duke marre pjese ne grup si anëtar te konzoriumit dhe bashkërisht jemi përgjegjës për përmbushjen e këtij aktiviteti të prokurimit. Poashtu ne kërkesën e AK-se te datës 3.07.2023 na kërkohet: *"Pasi qe keni shprehë konkurrencë në aktivitetin e prokurimit si grup i operatorëve për aktivitetin: "Riparimi i rrugëve lokale re rendit IV dhe sanimi i gjendjes nga vërshimet" me nr.prok.633-023-012-111, pas që aktiviteti në fjalë është në fazën e vlerësimit nga komisioni vlerësues, para rekomandimit të ofertës përgjegjëse nga komisioni vlerësues dhe ngritjes së vendimit nga Zyra e prokurimit, kërkojë nga ju si grup që të deklaroheni me deklaratë veç e veç për obligimet e përbashkëta sipas marrëveshjes dhe ndaras" ne jemi përgjigjur me deklarata veç e veç qe obligimet i kemi te përbashkëta dhe sipas marrëveshjes se koncerziumit dhe ju kemi dërguar Deklaratat e nënshkruara dhe vulosura nga anëtaret e konzorciumit ashtu siç AK i keni kërkuar , ku deklarojmë qe si anëtar të konzorciumit jemi përgjegjës për realizimin e kësaj kontrate, dhe po ashtu deklarojmë qe jemi duke marre pjese ne këtë aktivitet si konzorcium (Armendi Bau- si lider dhe Company Zuka Commerce- si anëtar i konzoriumit). Me këtë rast eliminimi jonë për këtë arsye është tërësisht i pabazuar dhe ne Kundërshtim me LPP-në ku Komuna e Istogut ka bere shkeljen e LPP, Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi Poashtu ne piken 10 te udhëzuesit për prokurim publik nr.001/2023 shkruan tekstualisht "* **Mungon deklarata e nënshkruar nga secili anëtar për konfirmim të pjesëmarrjes** *" ,* **ndërsa ne si OE me deklarate ne marrëveshjen e koncerziumit e konfirmojmë pjesëmarrjen . (Tek oferta jonë referoju File me emërtimin 1. Marrëveshja e konzoriumit)**

Poashtu as pas vendimit të OSHP -se numër OSHP 2023/0649 , Autoriteti Kontraktues nuk ka kërkuar kurrfarë sqarimesh ,dhe nuk e ka zbatuar vendimin e OSHP-se dhe njëkohësisht duke u bazuar te ne qasjen ne dokumente zyrtare qe na janë ofruar nga AK Komuna e Istogut kemi vërejtur qe Autoriteti Kontraktues , Komuna e Istogut , as kompanisë qe i ka dërguar letër për tenderues te suksesshëm fare nuk e ka përdorur Nenin 72 për sqarimin e pretendimeve te Kompanisë tone , te cilat OSHP ne vlerësimi i ka

bere te bazuara dhe ne te njëjtën kohe kompaninë e ka bere te papërgjegjshme sa i përket pretendimeve tona .

Duke u referuar pretendimeve si më sipër "ARMENDI BAU" SH.P.K., konsideron se Autoriteti Kontraktues ka shkelur nenin 6, 7, 59, 65, 66, 68, 69 DHE 72 të LPP-së. Duke propozuar të anuloni B58 – njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues, të datës: 27.12.2023, Lëndën me titull**:** "Riparimi i rrugëve lokale te rendit IV dhe sanimi i gjendjes nga vershimet.633-023-012-111"**,** ta ktheni në rivlerësim dhe me rekomandim të na shpallni fitues Konzorciumin tonë , pasi që pretendojmë që AK nuk e ka zbatuar vendimin e OSHP-së.

Përgjigjja e AK-së ndaj kërkesës për rishqyrtim. "*Autoriteti Kontraktues- Komuna e Istogut Kërkesën për Rishqyrtim e HUSHE POSHTE si te pa bazuar ,shtojcë keni letrën standarde me statues për tenderuesin e eliminuar të cilin e keni pranuar së bashku me Vendimin e Autoritetit Kontraktues mbi rezultatin prokurimit pas Rivlerësimit nga komisioni Ri-vlerësues dhe aprovuar nga zyra e Prokurimit.* Grup i Operatorëve Ekonomik ARMENDI BAU SH.P.K.; Company Zuka Commerce Sh.p.k., Rr. Shpend Kukiqi nr.50, 31000, Suhogërllë Istog Sipas vendimit të AK njësisë së prokurimit komuna Istog të datës 17.07.2023 , Në marrëveshjen e Konzerciumit nuk është paraqitur deklarata e pjesëmarrësve ne konsersioum e nënshkruar dhe e vulosur nga të gjitha pjesëmarrësit e grupit, pasi qe ka konkurruar si grup i operatoreve te cilët kanë marre pjese dhe nuk e kane respektuar nenin 71 të LPP piken b te nenit 26 të rregullores së Prokurimit Publik nr.001/2022 e cila Citojmë: *Nëse një tender dorëzohet nga një grup i tillë, grupi duhet që së bashku me tenderin e tij të dorëzojë një deklarate të nënshkruar nga secili prej anëtarëve, që konfirmojnë pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk marrin pjesë në ndonjë grup tjetër që merr pjesë në të njëjtat procedura të prokurimit pran të njëjtit Autoritet Kontraktues për të njëjtin Aktivitet. Të gjitha Autoritetet Kontraktuese duhet që ta parashtrojë këtë kusht në dosjet e tyre të tenderit. Në rast së një anëtar merr pjesë në disa grupe, secili nga grupet përkatëse do të konsiderohen të papërshtatshëm-të pa përgjegjshëm* rregulloren numër 001/2022 te datës 20.10.2022, Neni 26.1.pika b. *Dorëzon një deklaratë të nënshkruar nga secili nga anëtarët*, që konfirmon *pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se nuk janë duke marrë pjesë individualisht dhe/ose në grupe tjera në procedurën e njëjtë të prokurimit (deklarata elektronike mund të nënshkruhet duke përdorur nënshkrimin elektronik të avancuar nëse është i aplikueshëm. Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë te parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092."*

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 03.01.2024 ka autorizuar ekspertin për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 1066/23, ndërsa me datë 05.01.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit me nr. 2023/1066 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që lënda të trajtohet si çështje e gjykuar sipas vendimeve paraprake të OSHP-së.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, "Autoriteti kontraktues nuk ka dhënë përgjigje ne me raportin e ekspertizës . Ndërsa OE pajtohet pjesërisht me raportin e ekspertit shqyrtues "

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për te vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore ne kuptim te nenit 24 paragrafi 1 te Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE "ARMENDI BAU" SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2023/1066 ka vlerësuar si në vijim:

Aktiviteti i prokurimit me titull: "Riparimi i rrugëve lokale te rendit IV dhe sanimi i gjendjes nga vershimet.633-023-012-111" *me nr. të prokurimit: "* 633-23-2733-1-1-1*", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)* – "Komuna e Istogut"**,** *ka filluar me publikimin e njoftimit për kontratë me datë 27.03.2023, hapja e ofertave është bërë me datë 19.05.2023, njoftimi mbi vendimin B58-Rivlerësim publikohet me datë 18.12.2023.*

OE ankuesi është i eliminuar me arsyetimin se nuk ka plotësuar deklaratën e përcaktuar sipas nenit 26.1 pika B e rregullores 001/2022 për prokurim publik.

Tutje OE ankuesi pretendon se AK nuk ka respektuar vendimin e panelit shqyrtues me nr. 2023/0649 dt.20.11.2023, si dhe ka shkel nenin 6,7,59,65,66,68,69,72 të LPP-së.

***Ekspertja Shqyrtuese** sa i përket arsye së eliminimit të OE ankues sqaron se, OE ankuesi në vendimin e PSH.2023/0649 dt.20.11.2023, veç se është shpallur i pa përgjegjshëm, dhe si e tillë sa i përket pretendimit të OE ankues konsideroj se është çështje e gjykuar.*

"në platformën elektronike, kërkesë e cila duhet të përcaktohet në dosje të tenderit. Fakti qe OE ankues nuk e ka dorëzuar deklaratën e parapare në piken B të nenit 26 të rregullores e bene ketë operatore ekonomik të papërgjegjshëm administrativisht dhe njëherit i njëjti nuk është palë me interes për ketë aktivitet të prokurimit sepse në piken 10 të udhëzuesit për prokurim publik nr. 001/2023, ne rast se një operatore ekonomik nuk e dorëzon deklaratën e cituar me lart, i njëjti duhet të eliminohet pa kërkuar sqarime të mëtutjeshme. Paneli shqyrtues e mbështet këtë konstatim të ekspertit shqyrtues, andaj pretendimi ankimor është i pabazuar dhe rrjedhimisht OE ankues është i papërgjegjshëm për këtë aktivitet të prokurimit."

Gjerësa, sa i përket OE të rekomanduarit, gjithashtu Vendimi i PSH nr. 2023/0649 dt.20.11.2023, ka shpallur të pa përgjegjshëm, dhe si e tillë është çështje e gjykuar.

Vendimi PSH. 2023/0649 dtL:20.11.2023

"ndërsa ka të bashkangjitur një DUD. Andaj, duke u bazuar në nenin 71 të LPP, asnjë OE nuk mund të mbështetet në kapacitetet e një OE tjetër me të cilin nuk ka marrëveshje të konzociumit, apo nuk ka bërë marrëveshje mbi marrjen me qira të pajisjeve nëse është lejuar me Dosje të Tenderit. Rrjedhimisht OE i rekomanduar për kontratë nuk ka plotësuar kërkesën e Dosjes së Tenderit dhe është i papërgjegjshëm për këtë aktivitet të prokurimit. Vlenë të theksohet fakti se edhe sa i përket grejderit i cili figuron se është në defekt, në procedurën e vlerësimit AK për këtë nuk ka bërë asnjë monitorim apo sqarim me OE."

*Si përfundim, aktiviteti i prokurimit në fjalë, pas vendimit të panelit shqyrtues me nr 2023/0649 dt.20.11.2023**,** gjatë procesit të rivlerësimit nuk është respektuar, andaj meqenëse në procedurë ekzistojnë ofertues të tjerë, atëherë si e tillë konsideroj se lënda duhet të kthehet në rivlerësim, në mënyrë që të respektohet vendimi i panelit shqyrtues."*

- Konstatimi i Panelit Shqyrtues –

Në fakt (natyrisht pavarësisht nga rekomandimet) Paneli vëren se procedura e prokurimit e cila është aplikuar në ketë rast është prezantuar në detaje në raportin e ekspertizës së ekspertit shqyrtues, duke i shpjeguar të gjitha fazat e procesit dhe veprimet e ndërmarra nga palët në kontekstin krahasues me aktet në fuqi, posaçërisht me Rregullat për Prokurim Publik. Prandaj Paneli mbështet shpjegimet e ekspertit shqyrtues i cili ka shpjeguar në raportin e ekspertizës së tij si dhe mbështet rekomandimin e ekspertit që lënda të kthehet në ri-vlerësim.

Paneli vlerëson se Autoriteti Kontraktues - Komuna e Istogut, zyrtari përgjegjës i prokurimit dhe komisioni i ri-vlerësimit gjate vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve, nuk e ka marr për bazë fare Vendimin e OSHP- së nr. 2023/0649 të datës 20.11.2023, andaj, ankesa e OE ankues përsëritet për herë të dytë dhe se ankesa konform Rregullores së Punës se OSHP-së konkretisht neni 16.2 te trajtohet si "Res Judicata".
Po ashtu neni 105 paragrafi 2.16 i LPP-së sqaron: "Në rastet e përsëritura me të njëjtat pretendime ankimore, ku objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, në rastet të cilat janë shqyrtuar më parë, Kryetari i Panelit Shqyrtues i trajton si çështje të gjykuara "res judicata".
Në bazë të sqarimeve të lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozojnë panelit shqyrtues që të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në Rivlerësim dhe në fazën e ri-vlerësimit AK të respektoj dhe zbatoj vendimin e lartcekur të nxjerrë nga OSHP. Ngase, sipas këtij vendimi edhe OE ankues i cili ankesën e ka për herën e dytë por edhe OE i rekomanduar për kontratë nga ana e AK për herën e dytë janë kualifikuar të papërgjegjshëm për këtë aktivitet të prokurimit. Prandaj parashtruesi i ankesës si dhe OE i rekomanduar për konstratë nuk mund ta ketë tani në ketë fazë statusin e palës me interes në kuptim të paragrafit 1.26, të nenit 4 (Përkufizimet), të LPP, sipas të cilit palë e interesuar është personi që mund të *dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit*.
Pas analizimit të shkresave të lartpërmendura të cilat i kishte në dispozicion Paneli Shqyrtues, si: Ankesat e OE ankues, raportet e ekspertit shqyrtues, vendimin nr.2023/0649, dihet mirë se

vendimet e OSHP-së janë të detyrueshme për autoritetet kontraktuese dhe të gjitha palët në procedurë, dhe se kundër vendimeve të OSHP-së, palët mund të ankohen në gjykatën kompetente brenda afatit ligjor me mjete të rregullta juridike, në përputhje me këshillën juridike të dhënë në vendim.
Andaj, Paneli Shqyrtues kërkon nga Autoriteti Kontraktues (AK) Komuna Istog që në tërësi të zbatohet vendimi i PSH nr.2023/0649 dhe pasi që ekzistojnë edhe oferta tjera atëherë vlerësimin e ofertave të cilat janë palë me interes, ta bëjë konform nenit 59 të LPP. OSHP-ja urdhëron Autoritetin Kontraktues (AK) - Komuna Istog që të ndërmarr masa për zbatimin e vendimit të lartpërmendur në afat prej pesë (5) ditësh, mos respektimi i këtij urdhri, në afat prej pesë ditësh kalendarike, do ta detyrojë panelin shqyrtues që të respektoj nenin 131 të LPP-së dhe njëkohësisht do të kërkojë nga KRPP-ja që ti anulojë licencën menaxherit të prokurimit të Autoritetit Kontraktues (AK) - Komuna Istog në pajtim me nenin 25 paragrafi 8 dhe 9 të LPP-së.
- Përfundim -
Bazuar në të lartcekurat, Paneli shqyrtues konsideron se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 56.3, 59 dhe 60 të LPP, të cituara në Ankesë. Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në ketë rast përbejnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim sepse në të kundërtën do të bije ndesh me fushëveprimin e LPP dhe bazën argumentuese të pretendimeve ankimore, të cilat Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 104 lidhur me nenin 105 të LPP. Kthimi i një aktivitetit të prokurimit me bazë kontestuese ligjore ri-vlerësim, është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji".

Lidhur me nenin 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: "Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës..." Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues ne pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **KOMUNA E ISTOGUT**
- OE - **ARMENDI BAU SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: